

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                   |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Ish-kreu i SHISH nën arrest/ Valteri: Standardin që Rama përdori për shkarkimin e Vlora Hysenit, duhet t a ndiqte edhe për Ballukun! Kthupi: Dosja e SPAK ka baza të forta! - Shqiptarja.com      |
| ADRESA  | https://shqiptarja.com/lajm/ishkreu-i-shish-nen-arrest-valteri-standardin-qe-rama-perdor-i-per-shkarkimin-e-vlora-hysenit-duhet-ta-ndiqte-edhe-per-ballukun-kthupi-dosja-e-spak-k-a-baza-te-forta |
| BURIMI  | shqiptarja.com                                                                                                                                                                                    |
| GJENDJA | edited                                                                                                                                                                                            |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 28 shtator 2026, 19:44:17 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 19:41:18 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 46cd8cc494edd5005e6ad1e102e074ecb0f84b15ca3c604765b0f0c7ad9f5739 |
| TEKSTI     | 277e9ecef5d7b6c644d5e6f1c68566ec75aec4553658011426db3a0b6402aad6 |
| PAMJA      | 31b745a14ccbd20c8e3951a7458d6218bd00fb3200a83e6f1132b9981b1198a6 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | b1bf2b4a86ec9e7bf2cddb275f992133b4169cc10e4896eed00e47ee95b173ef                                |
| E MËPARSHMJA  | bccaf8375f286df3774e6e1462fbad31291a33152db1b3d6b7514a39b72bda8d                                |
| RRËNJA MERKLE | 81d9502dee89498020984867f5c9e7803768541a0034d6fb041c0efcf168cb37                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b1bf2b4a86ec9e7bf2cddb275f992133b4169cc10e4896eed00e47ee95b173ef>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Dritë në fund të tunelit, Mancini gjen fitoren e parë me Italinë! Mposht thellë Turqinë, fiton edhe Franca



Kronikë

Lajme nga emisionet

## Ish-kreu i SHISH nën arrest/ Valteri: Standardin që Rama përdori për shkarkimin e Vlora Hysenit, duhet ta ndiqte edhe për Ballukun! Kthupi: Dosja e SPAK ka baza të forta!

Ish-deputeti Valteri ngriti si hipotezë se Ergys Agasi mund të ketë qenë një agjent sekret për llogari të Vlora Hysenit dhe SHISH. Ndërkohë avokati Kthupi theksoi se problematika kryesore është procedura shtetërore e përgjegdhjes së Vlora Hysenit në krye të SHISH.

■ Ish-deputeti Valteri: Axhendë brenda SPAK për vrasjen politike të Veliajt, janë investuar 2 prokurorë!

■ Begaj mbledh Këshillin e Sigurisë: Hetimet e drejtësisë të mos cenojnë besimin te shteti!



Redaksia

28 Shtator, 21:36 | Përditësimi: 28 Shtator, 22:34

f Share Tweet

A A

Në studion e emisionit 'Repolitix' me gazetarin Denis Minga në Report Tv u diskutua mbrëmjen e sotme mbi hetimet e [SPAK](#) për drejtoreshën e shkarkuar të [SHISH](#), [Vlora Hyseni](#), që çuan në mbledhjen edhe të Këshillit të Sigurisë Kombëtare.

Ish-deputeti [Halit Valteri](#) tha se historia mes Vlora Hysenit dhe Ergys Agasit (i arrestuar më herët për dosjen e AKSHI-t) nuk duhet parë si një histori rozë. Valteri hodhi si hipotezë se Agasi mund të ketë qenë agjent që punonte për llogari të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Vlora Hysenit.



"Nëse kjo është e vërtetë, nuk e di se çfarë përmasash do marrë. Pastaj duhet parë roli ka luajtur ai djali që është në burg. Mund të ketë qenë një agjent i infiltruar i Vlora Hysenit. Kjo zonja nuk është një njeri i zakonshëm, ka drejtuar shërbimet e 2 vendeve, të Kosovës e Shqipërisë. Fakti që zonja i kërkon gjykatës që të bëhet ekspertiza e celularit të saj, që të bëhet nga agjenci të huaja serioze, do të thotë që ajo nuk ka besim sesi do të përdoren nga ata që do t'i shikojnë dhe nga mënyra sesi do të serviren. Tani supozojmë që Gysi mund të jetë agjent, sepse nuk jemi në kohën e Fahri Balliut që haje paçe dhe shikoje atë tjetrin kë takoi. Po e trajtuam histori rozë këtë, nuk kemi bërë asgjë", tha mes të tjerash Valteri.



[Sh]  
COM

LEXO EDHE:

**Ish-deputeti Valteri: Axhendë brenda SPAK për vrasjen politike të Veliajt, janë investuar 2 prokurorë! Citojnë Kushtetuesen për pagat, por s'e respektojnë vendimin e saj për kryebashkiakun**

Në vijim të fjalës së tij, Valteri tha se standardin që Edi Rama zbatoi me Vlora Hysenin, të cilën pas masave të sigurisë të nxjerra nga SPAK e shkarkoi nga detyra, kryeministri duhet ta zbatojë për çdo zyrtar tjetër nën hetim, përfshi edhe ish-zv.kryeministren Belinda Balluku.



"Kështu që pa parë se çfarë ka ndodhur, ne dimë që kanë dalë 2 faqe dhe është bërë një zhurmë e madhe dhe ka marrë një përmasë të madhe skandali. Duhet parë se çfarë ka hetuar SPAK. Rama këtë që bëri me Hysenin duhet të bëjë edhe me këtë që mban nën shtetull (Ballukun). Për të gjithë ata që përdorin pushtetin dhe besimin që u jepet për të kontribuar në këtë shoqëri, kështu duhet të jetë. SPAK ka një pushtet që nuk duhet cënuar nga askush", shtoi Valteri.

Nga ana tjetër, avokati [Rezart Kthupi](#) tha se dosja e SPAK për Vlora Hysenin ka baza të forta, përderisa në një hark të shkurtër kohor [GJKKO](#) pranoi kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për masat e sigurisë ndaj ish-kreut të SHISH.

Kthupi shtoi se problemi nuk është vetëm me Vlora Hysenin si individ, por sipas tij, me të gjithë



procedurën shtetërore të përzgjedhjes së saj në krye të SHISH.

Sipas Kthupit, SPAK duhet të zgjerohet hetimet dhe të shohë nëse Hyseni ka vepruar e vetme në ndarjen e informacioneve sekrete, apo ka edhe bashkëpunëtorë të tjerë të përfshirë.



*"Ajo dosje ka disa baza dhe i ka të mirë. Narrativa e Presidentit nuk duhet të jetë që 'kjo është çështje personale dhe duhet të zgjidhet në nivel personal'. Kur bëhet fjalë për titullar institucioni, këtu nuk bëhet fjalë për një çështje personale. Dhe një pyetje tjetër, 'kjo zonja Hyseni këtu punë i ka bërë vetëm?' Ne nuk e kemi problemin me zonjën Hyseni në vetvete. E kemi problemin me mënyrën sesi Hyseni vjen në atë post. Pra problemi është me të gjithë procedurën shtetërore të përzgjedhjes së njeriut më të rëndësishëm të sigurisë kombëtare", tha mes të tjerash Kthupi.*

Rendit zhvillimet sipas orarit: **Të Fundit**

Ora 22:32

**Ish-deputeti Valteri: Axhendë brenda SPAK për vrasjen politike të Veliajt, janë investuar 2 prokurorë! Citojnë Kushtetuesen për pagat, por s'e respektojnë vendimin e saj për kryebashkiakun**

Ish-deputeti Halit Valteri është shprehur se ka raste që prokurorë të SPAK, me axhenda private dhe pa asnjë provë, e përdorin detyrën për të 'vlarë' politikisht personazhe të caktuara politike.

Komentet Valteri i bëri në emisionin 'Repolitix' me gazetarin Denis Minga në Report Tv, ku mori si shembull rastin e mbajtjes në qeli të kryebashkiakut të Tiranës, Erion Veliaj, që sipas tij, është investim personal i 2 prokurorëve.

Valteri hoqi edhe një paralelizëm mes rastit të Veliajt dhe rastit të pagave të magjistratëve, ku tha se në rastin e parë kërkesa e Kushtetueses për Gjykatën e Lartë, që ta rivlerësonte masën ndaj kryebashkiakut nuk respektohet. Ndërsa për pagat e magjistratëve, sipas Valterit, gjyqtarët e prokurorët përdorin dhe kërkojnë respektimin e vendimit të Kushtetueses.



*"Nëse arrestohen ministra, kryebashkiakë, deputetë dhe u provohet fajësia në Gjykatë, do të thotë se Qeveria e mbështet SPAK dhe e mban këtë strukturë gjallë. Por marrim rastin e kryebashkiakut, është investim personal i dy prokurorëve. Gjykatë Kushtetuese i thotë 'vlerësoje masën' Gjykatës së Lartë, kërcënohen, vihen nën hetim e përgjim gjyqtarët e prokurorët dhe për rastin Veliaj nuk e zbatojnë vendimin e Kushtetueses, ndërsa për rastin e pagave thonë 'ka folur Gjykatë Kushtetuese', tha mes të tjerash Valteri.*

Në vijim të fjalës së tij Valteri tha se kryebashkiaku Veliaj shoqërohej nga 20 policë kur shkoi të kryente një operacion, ndërsa një personazh i botës së krimin të organizuar, sipas tij qarkullonte pa asnjë masë sigurie, aq sa arriti të arratisesh.

Valteri theksoi se nga 11 akuza që rëndojnë mbi Veliajn, deri më tani nuk ka asnjë akuzë për inceneratorët apo për lejet e ndërtimit, por vetëm për fustanet e gruas së tij, Ajola Xoxa.



*"Nuk lejohet Veliaj të operohet, me 20 policë brenda, ndërkohë ai rob i tjetër që akuzohet për 4 vrasje, me duar në xhepa, me syze dielli, u ikën me vrap policisë. Nuk lejohet Veliaj të takojë avokatët. Dhe kemi raste të tjera që Ben Ahmetajt vibratorët e gruas ua nxorën në publik, si ushqim për shikime. Dhe akuzohet Veliaj, ka 11 akuza, se ka blerë fustane Ajola Xoxa, por nuk shoh as akuzë për inceneratorët, as akuza për lejet e ndërtimit, se u bë nami në bashki, konfiskuan dosje e bënë... Do shkojë biseda si autokombanja e atij zotërisë", shtoi Valteri.*

Për të forcur tezën e tij se SPAK po tenton 'vrasjen politike' të Veliajt, Valteri tha se ai është i vetmi kryebashkiak që po hetohet nën masën e sigurisë 'arrest me burg', pasi 6 kryebashkiakë të tjerë po hetohen në gjendje të lirë.

Ai shtoi se nëse SPAK-ut do i lihet kjo liri veprimi, prokurorët e Strukturës së Posaçme do shkojnë edhe te ministrat e tjerë dhe kryeministri Rama. Me ironi Valteri tha se SPAK 'të fut plumbin' dhe më pas thotë 'më fal se të vrasa'.



*"Pra brenda këtij institucioni ka agjenda, sepse ke 6 kryebashkiakë të tjerë që hetohen në gjendje të lirë. I vetmi që mbahet në burg, është Veliaj. Ky është rasti që ka një agjendë brenda SPAK për ta vlarë politikisht një person. Sot s'ke nevojë të paguash vrasës me*

pagesë, sepse ke prokurorë që të vrasin politikisht. Në fund do të dalë Veliaj i pafajshëm. Kush mban përgjegjësi që jetën që ja kanë marrë atij. Do i japin 1500 euro në vit dhe do i thonë 'na e bëj hallall se gaboi Klodi'. Nëse ka skenarë të tillë, ata nesër do shkojnë te Rama dhe te ministrat e tjerë. SPAK të fut kokrrën e plumbit dhe thotë pastaj 'më fal se të vrava vlla', përfundoi Valteri.

R.Xh/Shqiptarja.com

Share

R.Xh/Shqiptarja.com

TAG: repolitix | vlora hyseni | SHISH | hetimet per grupin e agasit | spak | GJKKO | Halit Valteri | rezart kthupi

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★ 5.0 / 5 (1 vlerësim)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Ndalohej repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

### Sondazhi i ditës:

Ambasadori i ri i SHBA nis misionin, a besoni se do sjellë ndryshim në mjedisin politik?

26 Shtator, 18:15

Po Jo Disi

## Lajme të tjera



Ekskluzive/ Klodian Braho deklaroi në Këshillin e Sigurimit: Vlora Hyseni na doli gjatë hetimeve! Kreu i komanduar i SHISH: Deri tani s'kemi parë rrjedhje sekreteve që cenojnë sigurinë

28 Shtator, 22:16



Vlora Hyseni në 'arrest shtëpie'/ Dashi: SPAK të hetojë gjithë zinxhirin komandues të SHISH! Basha: Opozita të mos sulmojë institucionet, por të merret me fenomenin

28 Shtator, 18:43



Arrest i ish-kreut të SHISH/ PD kërkon dorëheqjen e Ramës, Spaho: Opozita di të bëjë vetëm zhurmë në Kuvend! Mazhoranca nuk është lëkundur

28 Shtator, 18:23



FOTOLAJM/ U komandua në krye të SHISH pas shkarkimit të Hysenit, Elvis Lila për herë të parë në publik! Merr pjesë në Këshillin e Sigurisë

28 Shtator, 16:47



'Një nga rastet më të paprecedenta', Spahiu: Këshilli i Sigurimit të reflektojë për skandalin e kreut të SHISH

28 Shtator, 14:41



Reforma territoriale ndez debate PS-PD tek 'Ligjet', rrëzohet kërkesa e opozitës për futjen e draftit të saj në rend dite, Manja: Nuk e kam në tryezë, duhet të ndjekë procedurën

28 Shtator, 13:17



Këshilli i Sigurimit u mbledh pas arrestit ndaj Hysenit/ Bardhi: Begaj manekin, aty kishte përfaqësues të Aasit!



Avokatët bojkot masave të sigurisë, rregullorja censuruese përçan gjyqtarët e GJKKO! Njëra palë kundër Erion Banit:



Grupi i hakerave iranien publikon mbi 700 numra telefonash të personelit të SHISH

28 Shtator, 11:07

### Rama të dorëhiqet



Danjela Maloku

28 Shtator, 12:24

### Duhet dialog! Tjetra kërkon ndëshkime më të ashpra



Keti Banushi

28 Shtator, 11:51



Magjistratët refuzojnë  
tryezën e Ramës për  
pagat: Dialog pas  
vendimit të  
Kushtetueses! Qeveria  
anulon takimin: Viojmë  
hartimin e ligjit të ri

28 Shtator, 09:19



Ish-kreu i SHISH nën  
arrest/ Begaj mbledh  
Këshillin e Sigurisë:  
Hetimet e drejtësisë të  
mos cenojnë besimin të  
shteti! Rama përballë  
Klodian Brahos



Danjela Maloku

28 Shtator, 07:48



Ylli Pata: Iluzioni i  
pushtetit që vjen nga lart



Ylli Pata

27 Shtator, 20:58

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kërko



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.